



Nr. Prot: 383
Data: 3/3/2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20, dhe në zbatim të nenit 73 dhe 100 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregullores nr. 937, datë 24.10.2023 për studimet e doktoratës, konkursit plotësues me nr. 5/861 të datës 30.12.2024 të shpallur nga Universiteti i Prishtinës, për pranimin e studentëve në studime të doktoratës, për vitin akademik 2024/25, në mbledhjen e mbajtur më datë 21.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet rekomandimi i Këshillit Qendror për Studime të Doktoratës për miratim të listave përfundimtare të kandidatëve për pranim në studime të doktoratës në vitin akademik 2024/25, nga konkursi plotësues me nr. prot: 5/861 të datës 30.12.2024, sipas propozimit të njësisë akademike përkatëse dhe atë: Fakultetit Mjekësisë, Fakultetit Filologjisë, dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.
- II. Kandidatët e pranuar në studime e doktoratës për vitin akademik 2024/25, do të regjistrohen me hyrje në fuqi të këtij vendimi.
- III. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (Ndërtesa e Bibliotekës Qendrore Universitare).
- IV. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili shkarkohet nga SEMS);
 - Dy fotografi të formatit 6x4cm;
 - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga SEMS);
 - Pagesa bëhet në një të njëjtin prej bankat afariste.
- V. Data e fillimit të ligjëratave caktohet nga njësit akademike përkatëse.
- VI. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë listat e kandidatëve të pranuar përkatësisht lista me nr. prot: 931 e datës 31.1.2025 e Fakultetit të Mjekësisë, lista dhe shkresa përcjellëse me nr. prot: 265 dt. 31.1.2025, e Fakulteti të Filologjisë dhe lista e datës 31.1.2025 e FIEK-ut.
- VII. Obligohen njësit akademike përkatëse që këtë vendim ta publikojnë në ueb faqen e njësisë akademike.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Ar sy e t i m

Këshilli Qendror për Studime të Doktoratës (KQSD), në mbledhjen e mbajtur me datë 18.2.2025 ka shqyrtuar raportet përfundimtare të Fakultetit të Mjekësisë, Fakulteti të Filologjisë dhe FIEK-ut, si dhe listat e kandidatëve të propozuar për pranim në studime të doktoratës për vitin akademik 2024/25.


KQSD, gjithashtu ka shqyrtuar zbatimin e procedurave ligjore të konkursit dhe Rregullores që ka qenë në fuqi për studime të doktoratës nga ana e njësive akademike të specifikuara në paragrafin 1 të dispozitivit të këtij vendimi dhe ka konstatuar se janë respektuar procedurat e përcaktuara sipas konkursit nr. 5/861 të datës 30.12.2024 dhe Rregullores nr. 937 dt: 26.04.2023, për studime të doktoratës.

Senati i Universitetit të Prishtinës, mbështetur në argumentet e sipërhënuara, bazuar dhe në rekomandimin e KQSD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura, mund të parashtrojnë ankesë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit në ueb faqen e universitetit. Palët ankesën duhet ta parashtrojnë në njësinë akademike përkatëse, pastaj njësia akademike përkatëse e procedon ankesën pranë Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit të UP-së.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Njësive akademike të UP-së
2. Zyrës për Çështje të studentëve;
3. Zyrës për Çështje akademike;
4. Zyrës Ligjore;
5. Arkivës së UP-së.



Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. Arbën Hajrullahu, Rektor